



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 30 DHJETOR 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 30. DECEMBRA 2016. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR  
2016**

## **Rendi i ditës**

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

## **Dnevni red**

1. Drugo razmatranje Nacrt zakona o izmenama i dopunama Zakona br. 04/L-261 o ratnim veteranima Oslobodilačke vojske Kosova.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës të caktuar me vendim të seancës së mëparshme plenare, datë 30 dhjetor 2016.

Fillojmë me të vetmen pikë:

### **1 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës**

Komisioni FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe komisionet e përhershme, në pajtim me vendimin e Kuvendit, datë 30 dhjetor 2016, e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e përkrahura nga Komisioni FunkSIONAL.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputetin Nehat Baftiu, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

NEHAT BAFTIU: I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të nderuar,

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në mbledhjen e mbajtur më 30 dhjetor 2016 diskutoi dhe e aprovoi raportin përfundimtar për Projektligjin nr. 05/L-141 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Raporti përmban 8 amendamente.

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale rekomandon që të autorizohet Drejtoria për Standardizimin, Përafrimin dhe Harmonizimin Ligjor të bëjë harmonizimin e tekstit në gjuhën serbe dhe angleze me tekstin e gjuhës shqipe. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë, jemi në pjesën e votimit të amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit FunkSIONAL.

A doni të votojmë në mënyrë elektronike apo me dorë?

Atëherë, votimin do ta bëjmë në mënyrë elektronike.

Amendamenti 1. Deputeti Nuredin Ibishi, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Lus regjinë dhe deputetë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Në sallë janë 65 deputetë.

Kanë votuar edhe 3 me dorë. Atëherë, a do të votoni ju tre gjithnjë me dorë?

Cili është votimi juaj që votuat me dorë?

Për 1, kundër 1 dhe Abdyli....

Atëherë, kemi 62 vota, 15 janë për, 14 elektronike dhe 1 me dorë, 41 kundër, 40 elektronike e 1 me dorë dhe 6 abstenime, nuk kalon.

Amendamenti 2. Deputetët Anton Quni, Armend Zemaj dhe Doruntinë Maloku, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Urdhëro, zoti Quni!

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë do të mundohem ta arsyetoj këtë propozim dhe kisha kërkuar nga të gjithë deputetët të kenë mirëkuptim.

Në fakt, ky amendament ka të bëjë me një përkufizim që lidhet me Ligjin bazik, do të thotë me Ligjin Nr. 04/L-261.

Sipas deputetëve të nënshkruar dhe një numri të konsiderueshëm të deputetëve, të cilët për çështje të kohës nuk arritën të nënshkruajnë këtë amendament, unë do ta lexoj amendamentin që ka të bëjë me nenin 3, paragrafi 1.3.2.

“Veteran luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është qytetari i Kosovës ose shtetas i huaj, i cili është radhitur në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe është regjistruar deri më 12 qershor 1999 si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga komandat, shtabet operative dhe zonave operative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Mbrojtja Territoriale, që aktivisht ka marrë pjesë në luftë”.

Të nderuar deputetë,

Ky amendament është në frymën gjithëpërfshirëse. Ne e dimë se shumë luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë rekrutuar, mobilizuar, stërvitur dhe autorizuar për të kryer operacione nga strukturat e ndryshme komanduese, dhe për t'i krijuar të gjitha parakushtet që të gjithë të trajtohen njëjtë, është mirë që ky amendament të votohet kështu, siç e citova. Faleminderit!

**KRYETARI: Faleminderit!**

Amendamenti 2, deputetët Anton Quni, Armend Zemaj dhe Doruntina Maloku, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Lus kolegët deputetë, të cilët tani të gjithë i kanë kartelat, të bëhen gati për votim dhe votojmë tash:

64 deputetë kanë votuar, 29 për, 33 kundër dhe 2 abstenime.

Amendamenti 3. Komisioni FunkSIONAL.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Kanë votuar vetëm 57 deputetë, të nderuar deputetë, pa votuar 61 nuk merret si i mirëqenë votimi.

A doni të votojmë me dorë, apo ta përsërisim votimin?

Pra, të nderuar kolegë deputetë, edhe një herë votojmë amendamentin 3 nga Komisioni FunkSIONAL.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Kanë votuar 62 deputetë. 58 janë për, 1 kundër dhe 3 abstenime, kalon amendamenti 3.

Amendamenti 4, dy propozime: a) Komisioni FunkSIONAL dhe b) Deputeti Nuredin Ibishi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Zakonisht, në rastin kur i kemi pasur dy propozime, kemi shkuar me dy votime, dhe cili ka marrë vota më shumë, ka kaluar.

Shkojmë me propozimin e parë, a) Komisioni FunkSIONAL.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

62 deputetë kanë votuar, 54 për, 6 kundër dhe 2 abstenime.

Tash votojmë propozimin nën b, deputeti Nuredin Ibishi.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Ju lutem, votoni, sepse nuk konsiderohet i aprovuar nëse s'janë 61 vota.

65 deputetë kanë votuar, 24 janë për, 32 kundër dhe 9 abstenime, kalon amendamenti 4 me propozimin e Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 5 i ka 3 propozime, që është rast i parë.

Atëherë, shkojmë me 3 propozimet, një nga një. Urdhëro, profesor!

E ka fjalën nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti, në ndërkohë kanë kërkuar fjalën edhe 2 deputetë.

SABRI HAMITI: Ky është amendamenti 5 dhe unë po i referohem këtij të Komisionit FunkSIONAL.

E keni në faqen 4, te pensioni mujor, e të tjera, 3 kategoritë. Vazhdimi, 5 ku shkruan dhe thotë: "Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, veteranët e luftës së UÇK-së, të cilët punojnë jashtë institucioneve dhe paguhen nga buxheti i Kosovës, si dhe në ndërmarrjet publike", logjikisht duhet të jetë "si dhe jashtë ndërmarrjeve publike" dhe vazhdon. Ky, ndryshe s'ka kuptim.

KRYETARI: E keni parasysh vërejtjen e nënkryetarit të Kuvendit për amendamentin 5, kur shkojmë në votim do të marrim parasysh vërejtjen e nënkryetarit të Kuvendit dhe amendamenti votohet me atë vërejtje.

A e do fjalën nga deputetët edhe ndokush?

Do të votojmë nën a, së pari, nga Komisioni FunkSIONAL.

Pra, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe e votojmë amendamentin 5, nën a, të Komisionit FunkSIONAL, me plotësimin e nënkryetarit të Kuvendit, Sabri Hamiti.

Pra, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

64 deputetë kanë votuar, 52 janë për, 9 kundër dhe 3 abstenime.

Ky ishte votimi i parë, shkojmë në votimin e dytë: Deputetët Anton Quni, Armend Zemaj dhe Doruntinë Maloku, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Anton, urdhëro, mund ta marrësh fjalën. Si po shihet, në ekran po tregon se janë të paraqitur 3 deputetë për fjalë, prandaj ose largoni emrat dhe kërkoni në mënyrë elektronike, ose vetëm me dorë pastaj, për të pasur më të qartë kush e do fjalën. Urdhëroni, fjala është për ju, zoti Quni.

ANTON QUNI: Faleminderit! Ideja pse e kemi propozuar këtë amendament është që ky amendament, të cilin edhe do ta citoj më vonë, është në frymën e ruajtjes së unitetit dhe marrëdhënieve të mira ndërnjerëzore të veteranët.

Veteranët shumë e më shumë janë duke u ndarë në kuptimin ideologjik, partiak, regjional e tjera, dhe nuk është mirë që tani veteranët t'i përçajmë edhe më shumë, duke i ndarë në kategori të ndryshme.

Nuk është mirë që veteranët e kategorisë së tretë, përkundër asaj që ishin protagonistë të operacioneve të rrezikshme, në luftime me intensitet të lartë, në kohë të gjatë të luftimeve, me fitore madhështore e nesër të bëhen objekt i talljeve dhe përqeshjeve nga kategoritë më të larta.

Deri te një kategorizim më specifik dhe më i mirëfilltë, ku do të duhej marrë parasysh edhe niveli i përgjegjësive në luftë dhe totali i orëve të luftimit, të gjithë veteranët luftëtarët do të duhej të trajtohen njëjtë.

Prandaj, në këtë frymë, ne deputetët e apostrofuam e propozojmë këtë amendament:

“Buxheti i përgjithshëm për realizmin e pagesës së pensionit të veteranit luftëtar të UÇK-së shfrytëzohet tërësisht gjatë vitit për këtë destinim dhe nuk mund të tejkalojë 0,7% të bruto-prodhimit vendor në vit, ndërsa pensioni i veteranëve luftëtarë do të ndahet në mënyrë të barabartë për të gjithë”.

Prandaj, me këtë amendament të gjithë veteranët në të ardhmen do të trajtohen njëjtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë, jemi para votimit të amendamentit 5, i cili i ka 3 propozime.

Amendamentin nën a, e kemi tejkaluar, nga Komisioni FunkSIONAL dhe tani jemi te votimi i propozimit nga deputetët Anton Quni, Armend Zemaj dhe Doruntinë Maloku, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, amendamentin 5.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim dhe votojmë tash:

64 deputetë kanë votuar, 27 janë për, 29 kundër dhe 8 abstenime.

Tash votojmë propozimin 3, i amendamentit 5. Deputeti Nuredin Ibishi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Urdhëro, zoti Ibishi!

NUREDIN IBISHI: I nderuar zoti kryetar,

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Duke qenë se u votua njëri prej amendamenteve nën a, që tash ndoshta duket e pakuptimtë kjo, por unë duhet gjithsesi të cek se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pjesa operacionale e luftës është zhvilluar në vitin 1997 - 1999, pra në të gjitha përkufizimet. Mirëpo, unë do ta lexoj në tërësi tekstin e amendamentit tim, me qëllim që realisht këto 3 kategori që janë dhënë më herët, nuk do të thotë që janë të pakuptimta, por sido që të jetë, tash janë miratuar dhe s'dua tash të diskutoj.

Mirëpo, sido që të jetë, po e lexoj tekstin e amendamentit tim.

Propozoj ndryshimin e nenit 16a pika 1, nën paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3 me tekstin e ri të nenit 16a.

Paragrafi 1. "Kategorizimi i veteranit luftëtar i UÇK-së si përfitues i pensionit dhe beneficioneve të tjera përcaktohen në përputhje me kohën e angazhimit vullnetar dhe mobilizimin për shërbim në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, si në vijim:

Nënparagrafi 1.1, kategoria e parë.

Pra, janë vetëm dy kategori:

Veteran-luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, vullnetar në luftë nga 1 janar 1997 dhe ka qenë aktiv deri në ditën përfundimtare të luftës, dhe

Nënparagrafi 1.2, kategoria e dytë.



Veteran-luftëtar i UÇK-së, i mobilizuar në luftë nga 31 marsi 1999 dhe ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës”.

Pra, e kemi një fazë, fazën primare, kur ka qenë sistemi vullnetar, një kategori dhe, i dyti, kur ka qenë mobilizimi nga 31 mars 1999.

Mendoj se ky do të kishte qenë kategorizimi i vërtetë, por mbetet te deputetët të përcaktohen për cilin variant janë.

KRYETARI: Faleminderit, zoti Ibishi! Të nderuar kolegë deputetë, përgatitemi për votim.

Jemi te propozimin 3, i deputetit Nuredin Ibishi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, amendamenti 5.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

65 deputetë kanë votuar, 21 janë për, 28 kundër dhe 16 abstenime.

Për hir të kursimit të kohës, numrin më të madh të votave për e ka marrë propozimi i parë nga Komisioni FunkSIONAL, dhe ky kalon.

Në qoftë se ka nevojë, unë e lexoj.

Jemi në amendamentin 6. Komisioni FunkSIONAL.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

64 deputetë kanë votuar, 59 janë për, 2 kundër dhe 3 abstenime, kalon amendamenti 6.

Amendamenti 7, deputetët: Anton Quni, Armend Zemaj dhe Doruntinë Maloku, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Anton Quni dhe Bekim Haxhiu e kanë kërkuar fjalën. Urdhëro, zoti Quni, si propozues.

ANTON QUNI: Faleminderit! Këtu do të jem shumë i shkurtër.

Ky amendament ka të bëjë me një përvojë që e kemi nga krijimi i Komisionit për verifikimin e veteranëve, sipas Ligjit bazik, ku anëtar i këtij komisioni ka qenë edhe një përfaqësues i Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës, prandaj me këtë amendament po ashtu kërkohet që në komisionin, i cili do të ngrihet, të jetë një anëtar nga Ministria e Mbrojtjes së

Republikës së Kosovës, krahas përfaqësuesve nga Zyra e kryeministrit, Shoqata e OVL-së, e të tjerë. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Haxhiu, urdhëroni!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Së pari, ose shprehja këtu që është propozuar, MMRKS, as nuk është në përkufizim të ligjit. Do të thotë është tërësisht e paqartë dhe nuk mund të kërkohej, e unë i kuptoj disa këtu që kanë nevojë të bëjnë histori, por nuk bëhet ligji me histori. Ligji rregullon një fushë të caktuar, e atëherë këtu duhet të futen edhe të tjerë dhe unë mendoj se është e panevojshme absolut të ndryshohet ligji bazik, ose projektligji.

KRYETARI: Zoti Zemaj dhe Anton Quni e kanë kërkuar fjalën, së pari Anton Quni.

ANTON QUNI: Me ligjin bazik përkufizohet Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës. Kjo nuk është çështje politike, është çështje teknike.

Shumë pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë të rekrutuar, të mobilizuar dhe të kyçur në operacione nëpërmjet kësaj ministrie, dhe për çështje teknike është mirë të ketë një përfaqësues të vetin që e lehtëson punën e komisionit, asgjë më shumë. Faleminderit!

Nëse doni, shkojmë në votim, të mos bëjmë më debat, për arsye se është e njëjta çështje të cilën jemi duke e bashkëbiseduar.

Pra, të nderuar kolegë deputetë:

Amendamenti 7. Deputetët Anton Quni, Armend Zemaj dhe Doruntinë Maloku, me përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

65 deputetë kanë votuar, 30 janë për, 34 kundër dhe 1 abstenim.

Amendamenti 8, deputeti Muhamet Mustafa, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Zoti Mustafa, fjala është për ju.

MUHAMET MUSTAFA: Ky amendament nuk ka ndonjë efekt financiar, si ngarkesë, por mund të ketë efekt pozitiv financiar dhe atë në dy drejtime: një në buxhet dhe dy, në rritjen e pensioneve të veteranëve, të cilët i plotësojnë të gjitha kushtet dhe janë veteranë të vërtetë.

Intenca e këtij është që procesi i verifikimit të atyre që kanë hyrë në lista të veteranëve të vazhdojë dhe të hiqen nga ajo listë ata të cilët nuk i plotësojnë kushtet për të gëzuar statusin. Dhe, unë mendoj se është mirë që ne të kemi një tekst të tillë, sepse edhe diskutimi ka qenë i tillë, por edhe në opinion kemi pasur një kërkesë të tillë.

Prandaj, i ftoj deputetët që ta aprovojnë këtë, dhe nuk e kuptoj pse komisioni nuk e ka përkrahur. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kolegë deputetë, vazhdojmë votimin.

Amendamenti 8. Deputeti Muhamet Mustafa, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash:

64 deputetë kanë votuar, 29 janë për, 31 kundër dhe 4 abstenime, nuk kalon.

Të nderuar kolegë deputetë, jemi te votimi i tekstit të Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Urdhëro, zoti Quni, merre fjalën!

ANTON QUNI: Faleminderit!

Kjo situatë më kujton një moment që e kemi kaluar, ishte po ashtu temë e njëjtë, kur personalisht nga ulësja këtu si deputetë, në atë kohë kryeministri ishte tani president, zoti Hashim Thaçi. Dhe, në lidhje me disa amendamente, të cilat prezantonin një unifikim të faktorit ushtarak dhe një tejkalim të të gjitha problemeve që i kemi pasur në të kaluarën, unë kërkoja nga ish-kryeministri dhe i thashë: “Zoti kryeministër, ju sot e keni mundësinë që të tregoni se jeni lider i të gjithë qytetarëve të Kosovës. Ju lutem, më mbështetni në këto propozime që po i bëj”.

Unë nuk e mora këtë mbështetje. Ligji u miratua, ashtu siç u miratua. Por, kur ishte në pyetje vota ime për zotin Hashim Thaçi që të bëhet president, në Zyrën e kryeministrit Isa Mustafa, në prezencën e tij, presidenti Hashim Thaçi m’i tha këto fjalë: “Unë jam i gatshëm ta procedoj ligjin. E di që kemi gabuar dhe këtë gjë mund ta përmirësojmë”.

Ju të gjithë sot e keni mundësinë t’i korrigjoni gabimet këtu në Parlament, gabimet politike që janë bërë, gabimet historike që janë bërë.

Unë po kërkoj që të pranohet dhe të miratohet një e vërtetë dhe një realitet.

Unë po ashtu lus kryeministrin tim, i cili në kohë lufte ka qenë homolog me ministrin e Mbrojtjes, kolonelin Ahmet Krasniqi, që të deklarohet për këtë çështje.

Në mandatin e kaluar e pata lutur ish-kryeministrin e Qeverisë së Kosovës në egzil, zotin Bujar Bukoshi. Nuk pranoi të deklarohet.

Nuk kisha pasur dëshirë që prapë kjo histori të përsëritet. Faleminderit!

KRYETARI: Zotëri Berisha e ka kërkuar në ndërkohë fjalën.

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, kryetar,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Unë kam ardhur personalisht që të jap mendimin tim për këtë ligj dhe t'ju lutem që të mos bëjmë përçarje në mes të veteranëve. Kjo është pika e parë.

KRYETARI: Ju lutem, ta dëgjojmë me vëmendje kolegun deputet! Është mendim i tij!

RRUSTEM BERISHA: E dyta, enkas kam ardhur, i nderuar kryetar për të përkrahur amendamentin e Anton Qunit, sepse ne jemi komandantë, unë jam komandant i Betejës së Kosharës dhe kjo formë çfarë ju po e praktikoni, ta dini se do të ndikojë në përçarje në masë.

Ju votoni ose mos e votoni, por nuk jemi duke shkuar drejt unifikimit të faktorit ushtarak. Dhe, jam më se i bindur se po të ishin edhe deputetët e opozitës, të njëjtin qëndrim do ta kishin.

Prandaj, pse s'kanë ardhur, ne e dimë, sepse deri e ka udhëhequr zoti Sabri Hamiti nuk kaloi votimi i parë dhe ne shkuam në shtëpi. Por kjo formë, në këtë mënyrë çfarë po tentohet të veprohet, mendoj se nuk është e drejtë dhe ju kisha lutur të mos i mos i përçani veteranët, mos i përçani veteranët, e ju votoni si të doni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Berisha! Kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa e ka fjalën. Në ndërkohë, është paraqitur për të marrë fjalën edhe Arben Gashi.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të gjithë ne, mendoj jemi angazhuar dhe e kemi për detyrë të angazhohemi që të krijojmë një hapësirë unifikuese të gjithë faktorit ushtarak të asaj periudhe.

E dimë si ka qenë koha, ne disa kemi kryer punë të ndryshme, mirëpo megjithatë kemi qenë në relacione dhe në përgjegjësi të caktuara.

Është e vërtetë kjo që deputeti Quni e tha këtu, sepse ka qenë edhe një shprehje e gatishmërisë edhe e presidentit Thaçi që ne të ulemi dhe të bisedojmë dhe të gjejmë bashkërisht gjithmonë formulime dhe zgjidhje, të cilat do të krijojnë mundësi të unifikimit ushtarak dhe politik në këtë ligj.

Tani unë nuk mund të them se a kemi pasur hapësirë ta bëjmë këtë tani, apo nuk kemi pasur, por unë megjithatë kërkoj që gjithmonë të kemi vullnet këtë ta bëjmë dhe, në qoftë se s'e kemi bërë sot, ta bëjmë nesër.

Qasja jonë në ndryshimin e këtij ligji ka qenë më tepër një qasje teknike, në mënyrë që të përplotësojmë kërkesat e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe fokusimi ynë ka qenë aty që ta kapërcejmë këtë në mënyrë që të mos rrëshqasim nga programi i Fondit Monetar Ndërkombëtar. Mirëpo unë megjithatë edhe do të angazhohem dhe ju kisha lutur si deputetë, që në një rast të ardhshëm, të ulemi e të shohim se cilat ndryshime duhet t'i bëjmë bashkërisht, në mënyrë që ligji të jetë ai që na përgjigjet të gjithëve dhe të gjithë ne do ta pranoni si dokument, i cili do të unifikonte. Tani nuk shoh ndonjë ndarje të veçantë, por do të thotë se ka mundësi që këtë bashkërisht ta realizojmë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Zoti Gashi, fjala është për ju. Në ndërkohë, edhe deputeti Shpejtim Bulliqi e ka kërkuar fjalën.

**ARBEN GASHI:** I nderuar kryetar, faleminderit!

Mendoj se, nëse ka vullnet Kuvendi, do të normohet një praktikë e mirë e tri vjetëve të fundit, që ka qenë edhe pjesë e Ligjit bazik në formimin e Komisionit për verifikim, ku edhe zoti Rustem Berisha ka qenë anëtar i Komisionit si përfaqësues i Ministrisë së Mbrojtjes dhe nëse ka vullnet Kuvendi, kjo nuk ka asnjë implikim financiar dhe nuk prish asnjë balancë dhe mund ta rikthejmë në votim amendamentin 7 dhe të krijohet një konsensus pozitiv. Nuk ka asnjë lloj implikimi as politik, as financiar, thjesht e krijon një komision, i cili e ka edhe një anëtar që e përfaqëson një pjesë të caktuar të luftëtarëve.

Mendoj se është një vullnet pozitiv. Ka qenë e normuar herën e kaluar, kanë dhënë përkrahjen edhe deputetët e PDK-së herën e kaluar dhe të njëjtit deputetët duhet të votojnë dhe besoj që nuk ka logjikë të mos votojnë diçka që kanë votuar herën e kaluar. Pra, normohet përbërja e komisionit, asgjë tjetër.

Nëse e normojmë përbërjen e komisionit, që e ka edhe përkrahjen e Komisionit Funkcional, është zgjidhje e mirë, krijohet një frymë më pozitive dhe më përfaqësuese. Faleminderit!

**KRYETARI:** Zoti Bulliqi, fjala për ju.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë desha shumë shkurt dhe të jem i qartë. Zakonisht projektligjet e tilla kur bëhen, bëhen në interes të atyre palëve për të cilët faktikisht është amendamentuar ky projektligj.

Mendoj se nuk është interesi i projektligjit që të mënjanohet një palë ose në njëfarë forme, të anashkalohej një palë, por mendoj se një pjesë relativisht të madhe të përgjegjësishë e mbajnë edhe ata që e kanë formuluar këtë projektligj, sepse vërtet nuk është në rregull që komplet kjo palë dhe komplet këto amendamente, të cilat u propozuan dhe të cilat mendoj se ishin shumë me vend, të refuzohen në këtë formë dhe në njëfarë forme, të shfrytëzohet mekanizmi i votës. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë, nuk ka të tjerë të paraqitur për diskutim.

Jemi në pjesën e votimit të projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Të nderuar deputetë, më lejoni të them rezultatin.

58 deputetë kanë votuar, 45 janë për, 6 kundër dhe 7 abstenime.

Kjo është situatë kur nuk kemi kalim të ligjit deri sa s'i kemi 61 deputetë që votojnë.

Urdhëroni, kush e do fjalën?

Kjo është e vullneti juaj politik. Shefat e grupeve parlamentare e kanë fjalën.

*(Ndërhyrje)*

Nuk kam të drejtë unë ta hedh në rivotim, e di ti mirë këtë.

Le të deklarohen kryetarët e grupeve parlamentare. Duhet të votojnë 61 deputetë, jemi në moment kur e kemi kaluar një kohë bukur të gjatë dhe tash na duhet vendimmarrja juaj. Duhet të votojnë 61 deputetë.

A doni ta vë prapë në votim? Ismet, Zenun, a e hedhim prapë në votim?

*(Ndërhyrje)*

Arben, ti e di mirë se unë nuk e kam mundësinë ta kthej në votim, sepse sikur ti të kishe kthyer në votim diçka, më kishe thënë pse po e thyen Rregulloren. Urdhëroni, Zenun Pajaziti, Ismet Beqiri dhe Duda Balje e kanë fjalën.

Pra, a jeni të gatshëm për të votuar? Urdhëroni!

ZENUN PAJAZITI: Kryetar, mendoj se, meqë kemi pritur dhe sot e dy ditë kemi punuar në këtë projektligj, secili prej nesh është i vetëdijshëm për çdo votë që e jep këtu. Po ashtu jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë që e kemi edhe për ligjin dhe për të gjithë ata që kanë qenë pjesë e luftës.

Mendoj se në mënyrën tonë qysh sillemi këtu dhe qysh votojmë, është se si e bëjmë edhe unitetin dhe mesazhin për to dhe nëse unë personalisht do të isha i bindur se ky projektligj do të dallonte diçka, do të dëmtonte cilindo që ka marrë pjesë në luftë, unë i pari nuk do ta votoja.

Kemi shumë kërkesa që të hyjnë në komision edhe pjesëtarët e organizatave të ndryshme e të tjera, dhe mendoj se duhet, zoti kryetar, ta qitni në votim dhe të dakordohemi të gjithë bashkë që të dalë projektligji në votim sot dhe ta votojmë të gjithë.

Unë i ftoj të gjithë deputetët, pa dallim, që ta japin votën e tyre dhe ta çojmë mesazhin edhe sipas porosisë së kryeministrit sot dhe partnerëve tanë, Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe mendoj se ky ligj është një bazë e mirë që më vonë, pastaj të shikohet edhe ndonjë korrigjim që ka të bëjë me çështje të tjera, përveç atyre që i tha kryeministri sot para nesh.

Pra, ju ftoj të gjithëve që ta votoni në tërësi projektligjin.

KRYETARI: Zoti Ismet Beqiri, nga Grupi Parlamentar i LDK-së. Ju kisha lutur të mos hapim debat për një çështje kur janë duke folur kryetarët e grupeve parlamentare.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar,

Unë lus deputetët, meqë e tha edhe kryeministri dhe gjatë debatit është thënë se nuk është diçka që s'mund të ndryshohet, por ne e kemi këtë projektligj dhe kemi ardhur në fazën finale të votojmë dhe të marrim obligim edhe për këto ndryshime, qoftë në përkufizim, qoftë edhe për pjesë të tjera dhe ta bëjmë të ardhmen, sepse askush nga deputetët këtë s'mund të na e ndalojë.

Pra, mendoj se është e drejtë të bëhen ato përkufizime, është e drejtë të përfshihen edhe këto kërkesa, por sot duhet ta votojmë dhe ju lus të merrni pjesë në votim të projektligjit.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Duda Balje, pastaj do të shkojmë në votim.

DUDA BALJE: Hvala predsedniče!

Pošto smo došli do ovde i da smo čuli reči gospodina premijera da sve ovo može da se naprave bilo kakve promene na zahtev poslanika, mislim da je red da danas glasamo, jer veoma veliki

broj ljudi očekuju od nas da budemo ozbiljni i da posle ovolikog rada danas ipak napravimo nešto za ratne veterane.

Parlamentarna grupa “6+” je saglasna time da se još jednom glasa.

KRYETARI: Faleminderit.

Të nderuar kolegë, jemi te votimi i tekstit të projektligjit në tërësi, me amendamentet e votuara.

Herën e parë nuk votuan 61 deputetë, pa e votuar 61 deputetë, ky ligj nuk kalon. Mund të votoni për, kundër dhe abstenim, por duhet të votojnë 61 deputetë.

Pra, në sallë janë prezentë 65 deputetë!

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

63 deputetë kanë votuar: 44 janë për, 8 kundër dhe 11 abstenime.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Me këtë i mbyll punimet e kësaj seance.

Deputetë të nderuar, në pajtim me nenin 37, paragrafi 3 të Rregullores së Kuvendit ju njoftoj se Sesionin vjeshtor i përfundoi punimet.

Sesionin pranveror do t’i fillojë punimet të hënën e tretë të muajit janar, më 16 janar 2017.

Mirupafshim në Sesionin pranveror. Urime Viti i Ri 2017. Gëzuar!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*